



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS  
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT  
NJËSIA E PROKURIMIT

Data 05.06.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“MATERIALE SPECIALE PER AKTIVITETE”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

18512200-3 Medalje

37529100-3 Lodra qe fryhen

37529200-4 Artikuj per parqe lojrash,lojra tavoline ose sallash

37822100-7 Lapsa me ngjyra

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër**

**Fondi limit i procedurës është: 1 665 983 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: "...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik..."

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vleren 33 319.66 (treidhjetë e tre mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: "...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël..."

"...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. 3. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe..."

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikaten ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme) "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" e cila të përfshijë objektin e prokurimit (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO).

2.1.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikaten dhe ISO 14001 ose ekuivalente (e vlefshme) mbi Sistemet e Menaxhimit Mjedisor. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO).

***Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.***

**Argumentimi:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 79, pika 1 ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga

*Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 2, germa (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, germa (b) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Kërkohet vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës, referuar nenin 43 pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi kjo është një procedurë e **Hapur e Thjeshtuar**, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: 333.196 (treqind e tridhjetë tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimi i se njëjtës natyre është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimi i se njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt e mëposhtem.

Artikulli <b>Nr.18</b> -Top tenisi	Cope	1
------------------------------------	------	---

Artikulli <b>Nr.24</b> -Shirit sinjalizues	m/linear	1
Artikulli <b>Nr 27</b> - Medaljon për vendin e parë me logo APR	Cope	1
Artikulli <b>Nr.32</b> - Set penela vizatimi dru dhe nailon	Set	1
Artikulli <b>Nr 34</b> - Tabelë shahu 40x40cm, material prej druri.	Cope	1
Artikulli <b>Nr 52</b> - Balona për fëmijë	Cope	1
Artikulli <b>Nr 54</b> - Qylyma (shtroje me thurje) outdoor per ulje (70cm x 100 cm).	Cope	1
Artikulli <b>Nr 33</b> -Set raketa ping pongu, (2 rraketa + 3 topa)	Set	1
Artikulli <b>Nr 55</b> - Trasta me material pambuku	Cope	1
Artikulli <b>Nr 2</b> -Rrjetë peshkimi dekorative	Cope	1
Artikulli <b>Nr. 6</b> -Perde dekorimi plastike (perde party) me ngjyra të ndryshme, (përmasa 1m x 2m)	Cope	1
Artikulli <b>Nr. 1</b> - Trofe (kupa) me përmasa të mesme	Cope	1
Artikulli <b>Nr. 11</b> - Aparaturë elektrike për fryrje tullumbacesh dekoruese	Cope	1
Artikulli <b>Nr. 14</b> -Top futbollit	Cope	1
Artikulli <b>Nr. 15</b> -Top basketbolli profesional	Cope	1
Artikulli <b>Nr. 16</b> -Top volejboli profesional	Cope	1
Artikulli <b>Nr. 17</b> - Rraketë tenisi, përmasa deri 70cm, trup alumini	Cope	1
Artikulli <b>Nr. 22</b> - Cilindra sfungjeri me ngjyra	Cope	1
Artikulli <b>Nr. 25</b> -Pëlhurë dekoruese	m/linear	1
Artikulli <b>Nr. 47</b> -Telajo (20x30 cm)	cope	1
Artikulli <b>Nr.57</b> - Argjile per modelim ngjyre e bardhe 500gr	cope	1
Artikulli <b>Nr.52</b> -Balona per femije	cope	1
Artikulli <b>Nr.46</b> -Flamastra 12 ngjyra	cope	1

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambientet e AK.
- Cdo moster e paraqitur pas orarit të percaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse.
- Mosparaqitja e mostrave është kusht për s'kualifikim.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet specifikisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mire mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK pasi artikujt do të përdoren nga grupe fëmijësh dhe është shume e rëndësishme cilësia e produkteve. Autoriteti kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike nëpërmjet paraqitjes së mostrave krijon mundësinë e kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim), të mostrave të dorëzuara, në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruara në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Ky kriter konsiderohet i nevojshëm dhe i rëndësishëm për vlerësimin e ofertës teknike të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurë.

**2.3.3** Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë nga administratori i shoqërisë ku të deklarojë se materialet janë të reja, të papërdorura, pa defekte dhe sipas sasisë dhe specifikave teknike të përshkruara nga autoriteti kontraktor.

**2.3.4** Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë nga administratori i shoqërisë për produktet si: Tullumbace në dimensione të ndryshme, Bojëra face painting, Bojëra akreliek me ngjyra të ndryshme, Plastelinë e lehtë set me 12 ngjyra, Dëngje kashte për dekor ku të deklarojë se këto artikuj nuk duhet të kenë elementë toksikë, nuk duhet të të thahen shpejt dhe mos të kenë aromë të fortë gjatë përdorimit.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar , Neni 77, pika 1 gërma ”c” si dhe të nenit 40 pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar kërkohet që operatorët ekonomikë të marrin përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi deri në magazinën e blerësit ne perputhje me kushtet e lëvrimin të mallit.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë nga administratori i shoqërisë ku merr përsipër transportin e mallrave, përfshirë ngarkim – shkarkimin në magazinë e Autoritetit Kontraktor i cili do të realizohet me mjetet dhe personelin e kontraktuesit.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar , Neni 77, pika 1 gërma ”c” si dhe të nenit 40 pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar kërkohet që operatorët ekonomikë të marrin përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi deri në magazinën e blerësit ne perputhje me kushtet e lëvrimin të mallit.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**


Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikullin e kërkuar vazo lulesh, përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Specifikimi i Materialeve:

- **Artikulli Nr 1 Trofe (kupa) me përmasa të mesme:**  
Trofe metalik me ngjyre Ari. Me përmasë të mesme. Ideal për aktivitete sportive midis ekipeve amatore.
- **Artikulli Nr 2 Rrjetë peshkimi dekorative**  
Varëse dekorative në formë rrjete peshkimi me përmasa 150x200 cm, material pambuku dhe MDF
- **Artikulli Nr 3 Polisterol me përmasat 5cmx50cmx100cm**



- **Artikulli Nr 4 Aparat për konturimin e polisterolit dekorues.**  
Me fuqi 6w, me hark për të dhënë formën që nevojitet. Kiti të përmbajë tel metalik rezervë, teh të gjatë dhe të shkurtër për prerje.
- **Artikulli Nr 5 Tullumbace me dimension 40 cm i fryrë, në pako 100 copë.**  
Material lateks, me ngjyra të ndryshme.
- **Artikulli Nr 7 Strukturë metalike gjysëm harku (përmasa 2.5m x2.8m).**  
Strukturë për dekorim në formë gjysëm harku, e ndërtuar me profile hekuri, me këmbë të qëndrueshme si në imazhin bashkëngjitur.



- **Artikulli Nr 8 Strukturë katrore metalike dekoruese (përmasa 2.5 m x 2.8m).**  
Strukturë për dekorim në formë katrore, me profile hekuri të montueshme, me këmbë të qëndrueshme si në imazhin bashkëngjitur.



- **Artikulli Nr 11 Aparaturë elektrike për fryrje tullumbacesh dekoruese.**  
Aparaturë elektrike për fryrjen e tullumbaceve, ideale për të fryrë numër të madh tullumbace në aktivitete, e projektuar me dy mënyra: manuale dhe automatike. Presioni: 18000 pa - 22000 pa, 1.75psi, Tensioni i hyrjes: 110-120V. Fuqia: 600W.
- **Artikulli Nr 12 Mjet për fryrjen manual të tullumbaceve.**  
Mjet për fryrjen e tullumbaceve. Material cilësor dhe rezistent. Dizajn kompakt dhe praktik. E lehtë për t'u përdorur.
- **Artikulli Nr 13 Top për ushtrime fitnesi, për fëmijë, diametër 50 cm.**  
Ideal për stërvitjen e muskulaturës trupore dhe zhdërvjelltësimin. Suporti i kapjes me duar e bën më të sigurtë dhe të qëndrueshëm pozicionimin e fëmijës gjatë lojës.
- **Artikulli Nr 14 Top futboli.** Që fryhet lehtë me anë të valvulës së sigurisë. Mban presion ajri nga 7 deri në 9 psi. Ka madhësi universale 6. Ideale për meshkuj të grupmoshave 9-12 vjeç, dhe për femra mbi 9 vjeç.
- **Artikulli Nr 15 Top basketbolli.**  
Fryhet lehtë me anë të valvulës së sigurisë, mban presion ajri nga 7 deri në 9 psi, ka madhësi universale 6.
- **Artikulli Nr 16 Top volejboli.**  
Fryhet me lehtësi me anë të valvulës së sigurisë. Mban presion ajri nga 7 deri në 9 psi. Ka madhësi universale 6. Ideale për meshkuj të grupmoshave 9-12 vjeç dhe për femra mbi 9 vjeç.
- **Artikulli Nr 17 Rraketë tenisi, përmasa deri 70cm, trup alumini.**  
Trup alumini, raketë tenisi e përshtatshme veçanërisht për fëmijë dhe për fillestarët.
- **Artikulli Nr 18 Topa tenisi.**  
Ndërtuar me material llastiku dhe fibre, të kenë qëndrueshmëri të lartë, të mos deformohen ose çahen dhe të jenë rezistentë, të përshtatshëm për të gjitha nivelet e përgatitjes.
- **Artikulli Nr 19 Fiksues Silikoni  $\Phi$  11mm.**  
Materiali: Plastik/Metalik, Fuqia: 40 W, Diametri i punës: 11 mm
- **Artikulli Nr 21 Mekanizëm tapicerie, 6-14mm, çelik.**  
Mekanizëm tapicerie 6-14mm; Materiali: Çelik; përdoret për fiksimin e tapicerive në dru, me një mekanizëm të fortë dhe rezistent.



- **Artikulli Nr 22 Cilindra sfungjeri me ngjyra.**  
Cilindra me material polietilen, me gjatësi 160 cm dhe diametër deri në 7 cm; ngjyra të ndryshme, struktura të lehta lidhese që ndihmojnë në krijimin e formave të ndryshme.
- **Artikulli Nr 23 Rrathë për akrobaci për fëmijë (hula hoop).**  
Material plastik me densitet të lartë, e cila eviton thyerjen apo shtrembërimin
- **Artikulli Nr 24 Shirit Sinjalizues.**  
Ngjyrë e kuqe me të bardhë, material plastik, rezistent.
- **Artikulli Nr 27 Medaljon për vendin e parë.**  
Material alumin, me derdhje, Diameter 35mm - 40 mm, me 1 unazë diam.3mm, me logo APR-së.
- **Artikulli Nr 28 Kavanoz dekorues i rrumbullakët transparent 15x11.5cm.**



- **Artikulli Nr 29 Ngjyruar akrilike me ngjyra të ndryshme, ambalazh 500 ml.**  
Ngjyra të ndryshme akrilike të përshtatshme për pikturim dhe lyerje; me paketim shishe plastike 500ml, të cilat thahen shpejt, janë kundra ujit dhe shumë të qëndrueshme
- **Artikulli Nr 30 Ngjyruar akrilik me ngjyra të ndryshme ambalazh 70ml.**  
Ngjyra të ndryshme akrilike të përshtatshme për pikturim dhe lyerje; me paketim shishe plastike 70ml, të cilat thahen shpejt, janë kundra ujit dhe shumë të qëndrueshme.
- **Artikulli Nr 31 Ngjyruar face painting, set me lapsa.**  
Të përshtatshme për lëkurë të ndjeshme, lehtë për t'u hequr, shabllone të ndryshme, pa parabenë, të jenë dermatologjikisht të testuar, antialergjik, të lahet me ujë.
- **Artikulli Nr 32 Set penela vizatimi, dru dhe najlon.**  
Penela për pikturë, prej materiali druri rezistent, me fije najloni, të cilët kanë gjatësi dhe madhësi të ndryshme të majës, për të realizuar teknika të ndryshme të pikturës. Përdoren për të pikturuar me bojëra akuarel, tempera dhe akrilik.
- **Artikulli Nr 33 Set raketa ping pongu, (2 raketa + 3 topa).**  
Raketa, material druri, me veshje gome, permasa 25cmx22cmx15cm; në formë ovale; topat, me material celuloid që nuk deformohen lehtë.
- **Artikulli Nr 34 Tabelë shahu 40x40cm, material prej druri.**  
Me përmasa standarte 40x40cm, punuar me dru cilësor, portabël. Gurët e shahut, material druri.
- **Artikulli Nr 35 Bobinë Pe Lini, 100gr.**  
Materiali lin, trashësia 3mm.
- **Artikulli Nr 36 Lojë rekreative outdoor në formë tapeti të stampuar në material plastik të gomuar, (futboll 4mx7m)**

Tapet i printuar në material plastik të gomuar, rezistent për aktivitete outdoor, në formë fushë futboli sipas imazhit bashkëlidhur. E tendosur në kornizë druri të palosëshme.



- **Artikulli Nr 37 Lojë rekreative outdoor në formë tapeti të stampuar në material plastik të gomuar, (“Shah” 2.5m×2.5m dhe aksesorët e lojës).**  
Tapet i printuar në formën e tabelës së Shah-ut, shoqëruar me 32 gurët e lojës me material plastik i qëndrueshëm, rezistent për aktivitete outdoor.
- **Artikulli Nr 38 Lojë rekreative outdoor në formë tapeti të stampuar në material plastik të gomuar, (Lojë “Twist” 2.5mx2.5m dhe aksesorët e lojës)** Tapet i printuar në formën e lojës Twist, material plastik i gomuar, rezistent për aktivitete outdoor.  
Shoqëruar me aksesorët e lojës (tabela rrotulluese me ngjyra dhe format e gjymtyrëve)
- **Artikulli Nr 39 Lojë rekreative outdoor në formë tapeti të stampuar në material plastik të gomuar, (“Mos u Nxeh” 4mx4m dhe aksesorët e lojës)**  
Tapet i printuar në formën e lojës “Mos u nxeh”, material plastik i gomuar, rezistent për aktivitete outdoor, shoqëruar me aksesorët e lojës (kone me ngjyra: 24 të kuq, 4 jeshil, 4 bojqielli, 24 të verdhë dhe 1 (një) zar)
- **Artikulli Nr 40 Lojë rekreative outdoor në formë tapeti të stampuar në material plastik të gomuar, (“Labirint” 2.5mx2.5m).**  
Tapet i printuar në formën e lojës “Labirint”, material plastik i gomuar, rezistent për aktivitete outdoor.
- **Artikulli Nr 41 Kuti lapsa pikturë me 12 ngjyra, material druri.**  
Lapsa me ngjyra në kuti me 12 copë, me majë 3.3mm.
- **Artikulli Nr 42 Solucion ngjitës didaktik, ambalazh 500gr.**  
Ngjitës vinovil i lëngshëm, me përmbajtje aceto-vinili, pa përbërës të dëmshëm apo toksikë për lëkurën, në ngjyrë të bardhë. Paketimi prej materiali plastik lejon aplikimin e ngjitësit edhe në sipërfaqe të vogla dhe nuk lejon që ngjitësi të thahet.
- **Artikulli Nr 43 Shirit ngjitës didaktik transparent.**  
Cilësia I-rë, 4 cm gjerësi ngjitjeje.
- **Artikulli Nr 44 Shirit ngjitës didaktik i dyanshëm.**  
Ngjitës letër nga të dyja anët, me gjerësi 12mm.
- **Artikulli Nr 45 Ngjitës nanotape.**  
Shirit ngjitës nga të dyja anët, material silikon.

- **Artikulli Nr 46 Flamastra 12 ngjyra.**  
Bojëra me përbërje lëndësore të sigurt, me bazë uji. Lahet nga lëkura me ujë dhe sapun, lahen lehtësisht nga veshjet.
- **Artikulli Nr 47 Telajo (20x30 cm)**  
E përshtatshme për bojëra akriliku ose vaji, material pambuk.
- **Artikulli Nr 48 Bisturi (thikë prerëse për materiale).**  
Thika me tehe të ndërrueshme me një material shumë cilësor. Me një dorezë mjaft të rehatshme duke lehtësuar përdorimin e saj pa lodhje.
- **Artikulli Nr 49 Vargje dekorative me ndarje trekëndore.**  
Ngjyra e flamujve e ndryshme; material copë mat, tafta pa shkëlqim; perimetri i trekëndëshit deri në 60 cm;
- **Artikulli Nr 50 Set Akuarele uji,paletë 12 ngjyra.**  
Kuti plastike me 12 ngjyra të thata të cilat lagen me uje për të pikturuar.
- **Artikulli Nr 51 Play Dough (brum loje) e lehtë, set me 12 ngjyra.**  
Të jetë e lehtë për t'u punuar dhe dhënë forma dhe të mos ngjisë në duar.
- **Artikulli Nr 52 Balona për fëmijë**  
Strukturë me material plastik, me veshje prej cope, me dizenjo dhe forma të ndryshme, rezistente ndaj erës për t'u ngjitur në lartësi të mëdha.
- **Artikulli Nr 53 Struktura ulëse per aktivitete outdoor, (me sipërfaqe suprinë 1m x 0.5m dhe lartësi nga toka 40 cm; material druri.**  
Tavolina didaktike të ultta për aktivitete outdoor (me sipërfaqe suprinë 1m x 0.5m dhe lartësi nga toka 40 cm; material druri. Material druri rezistent, struktura duhet të ketë mbështetje të sigurt në tokë dhe këmbët të jenë të përforcuara, në lidhje me njëra - tjetrën.
- **Artikulli Nr 54 Qylyma (shtroje me thurje) outdoor për ulje (70cm x 100 cm).** Tapet shumëngjyrësh me thurje, material pambuk, i përshtatshëm për ambient outdoor.



- **Artikulli Nr 55 Trasta me material pambuku.**  
Trasta me material pambuk, ose dok, të spampuara me ngjyra të ndryshme, me përmasa 37cm x 41cm, dy rripa normalë.
- **Artikulli Nr 56 Aparaturë për fryrjen e strukturaverekreative outdoor.**  
Produkti të këtë zhurmë të ulët, vëllim të madh ajri, presion të lartë të erës, peshë të lehtë, instalim të lehtë, të sigurt dhe të besueshëm. AC 220-240V, 50Hz, 8A, 1500W dhe të shoqërohet me kablllo zgjatues.

- **Artikulli Nr 57 Argjilë për modelim ngjyrë e bardhë, paketim 500gr.**  
Mund të punohet me duar ose për të veshur materiale të ndryshme (tel, dru.). Të thahet natyrshëm në ajër për 24 orë, duke mos pasur nevojë të punohet me furra në temperatura të larta.
- **Artikulli Nr 58 Dëngje kashte për dekor sipërfaqe 1m x50cm x40cm.**  
Dëngjet e kashtës do të përdoren për dekor dhe funksion ulës gjatë aktiviteteve outdoor. Me përmasa 1m x50cm x40cm; duhet të jenë shumë të presuara për t'i rezistuar kushteve atmosferike.
- **Artikulli Nr 59 Platformë për aktivitete me ping pong në natyrë. E hapur, mbulon nje sipërfaqe: 2,74mx1,52mx0,76 m.**  
Struktura ku mbështetet është çelik, me katër rrota dhe me këmbë në formë cilindri me diametër jo më të vogël se 40mm dhe të rregullueshme edhe për ambient jo të sheshtë; trashësia e platformës deri në 6 mm, material MDF dhe korniza rrethuese deri në 50mm; Rrjeta ndarëse prej najloni të gershetuar që është i fortë dhe rezistent ndaj goditjeve.
- **Artikulli Nr 60 Thasë për lojra argëtuese rekreative**  
Materiali beze, përmasat 120 cm x 70 cm me dizajn të stampuar

*Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.*